




PROJEKT BUXHETI 2016-2018

**ZBATIMI I POLITIKAVE PËR RRITJEN E
EFIÇENSËS DHE EFEKTIVITETIT NE
PERDORIMIN E BURIMEVE
FINANCIARE**

LOGO

www.wondershare.com

- BASHKIA VORE E RISTRUKTURUAR



Hyrje

KAPITULLI I Prioritet e Vitit 2016

KAPITULLI II Buxheti i Bashkisë Vorë për Vitin 2016

II.1 Të Ardhurat e Bashkisë Vorë për vitin 2016

II.2 Transfertat nga Buxheti i Shtetit

II.3 Parashikimi i shpenzimeve për vitin 2016

KAPITULLI III Programet Buxhetore

III.1 Programi Buxhetor i Shërbimeve Publike Vendore

III.2 Programi i Buxhetor i Infrastrukturës Rrugëve

III.3 Programi Buxhetor i Administratës

III.4 Programi i Buxhetor i Kulturës, Rinisë, Turizmit dhe Sportit

III.5 Programi Buxhetor i Shërbimeve dhe Kujdesit Social

III.6 Programi Buxhetor i Shërbimit të Gjëndjes Civile

HYRJE

Arti i buxhetimit në qeverisje është në thelb një proces i shpërndarjes së burimeve të kufizuara financiare për shërbimet dhe aktivitetet në një mënyrë që do të përmbushë më efektivisht nevojat e qytetarëve

Hartimi i Buxhetit për vitin 2016 vazhdon në rrugën e nisur dhe të konsoliduar e cila mbështetet në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.8, Datë 27.02.2015, për “Përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018”, si dhe në Ligji Nr. 115/2014 “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale Të Njësisë Të Qeverisjes Vendore Në Republikën E Shqipërisë” si dhe VKM për zbatimin e ligjeve të vecanta.

Programi i Kryetarit të Bashkisë Vore për mandatin 2015-2019 ka qene dhe do të jetë shtylla kryesore e përcaktimit të sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimit të prioritetëve të shpërndarjes së burimeve financiare dhe për periudhën 2016-2018.

Në qëndër të angazhimit të politikave dhe projekteve të Bashkisë është zhvillimi ekonomik, punësimi dhe përmirësimi i infrastrukturës në Vore, Preze, Berxulle dhe Domje, në çdo cep të zonës duke përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve. Për një qytet ku bashkëjeton tradita me modernen, ku të rinjtë realizojnë aspiratat e tyre për shkollim dhe punësim, ku të moshuarit jetojnë ditë të bardha, një qytet që ka gjithmonë një dorë të zgjatur për të nxjerrë nga vështirësia dhe ku problemi yt gjen një zgjidhje.

Këndvështrimi qytetar i shprehur në formën e opinionëve apo perceptimeve të ndryshme nëpërmjet të gjithë formave dhe mekanizmave të tjerë të thithjes së këtij mendimi na orientuan në hartimin e këtij projekt buxheti për vitin në vijim. Mendimi i qytetarëve dhe programet, lidhen me funksionet respektive të pushtetit vendorë të përcaktuara me ligj.

Programet pjesëmarrëse në Programin Buxhetor Afatmesëm janë:

- a. Programi Buxhetor i Shërbimeve Publike Vendore;**
- b. Programi i Buxhetor i Infrastrukturës Rrugëve;**
- c. Programi Buxhetor i Administratës;**
- d. Programi i Buxhetor i Arsimit Kulturës, Rinisë, dhe Sportit;**
- e. Programi Buxhetor i Shërbimeve dhe Kujdesit Social;**
- f. Programi Buxhetor i Shërbimit të Gjëndjes Civile.**

Çdo program përfshin të gjitha shpenzimet që do të shërbejnë për realizimin e objektivave të tij, të detajuara sipas klasifikimit ekonomik në:

- a. Shpenzime korente** (paga, sigurime, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, etj.);
- b. Shpenzime kapitale.**

Programi buxhetor financiar për vitin 2016 bazohet në analizën e kostove të programeve dhe shërbimeve në vite si edhe në vendimmarrjen për rritjen e standarteve apo cilësisë së tyre.

Këto analiza janë shoqëruar me metoda buxhetimi të cilat garantojnë zbatimin e politikave në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të burimeve financiare, në përputhshmëri me ndikimin e programeve të ndryshme në zhvillimin ekonomik të qytetit. Teknikat e përdorura për hartimin e buxhetit janë :

- Përgatitja e buxhetit bazuar në detyra/program.
- Përgatitja e buxhetit të balancuar.

KAPITULLI I

PRIORITET PËR VITIN 2016

Një buxhet nuk është vetëm një deklaratë financave, por është lidhja midis mobilizimit të fondeve dhe arritjes së qëllimeve dhe objektivave të qeverisë vendore. Njëkohësisht ky buxhet është legjitim pasi i referohet procesit të Buxhetimit me pjesëmarrje dhe për çdo pjesë i referohet legjislacionit në fuqi. Njëkohësisht ai ka përmirësim të strukturës së shpenzimeve në drejtim të shërbimeve publike, shtim të investimeve në infrastrukturen rrugore, zhvillimi dhe pasurimi i programeve mbështetëse të rëndësishme të Bashkisë së Vores, të gjitha këto janë shtylla kryesore në të cilat është mbështetur hartimi i buxhetit dhe synojnë të ndikojnë në:

- Rritja e cilësisë së jetës
- Rritja e shanseve për punësim
- Zhvillimi ekonomik i bashkisë së madhe Vore
- Zhvillimi i infrastruktures për biznesin
- Perkohje sociale
- Investime në rrugë
- Investime në infrastrukturen arsimore
- Zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive.

Programet prioritare ku do të përqëndrohet puna e Bashkisë për vitin 2016 paraqiten si vijon:

1. Rrugët dhe Kanalizimet e Ujërave të bardha dhe të zeza

Bashkia nëpërmjet këtij buxheti do të përmbushë impenjimet e Kryetarit, për Rehabilitim të rrugëve. Për rehabilitimin e rrjeteve, trotuareve, shtimit të sipërfaqeve të gjelbërta. Do t'i jepet zgjidhje përfundimtare Investimeve të nisura në qytetin Vore si dhe në fshatrat përreth, gjithashtu permisimi i infrastruktures rrugore do vijë edhe nëpërmjet investimeve të reja në të gjithë bashkinë e madhe Vore. Fondi për investimet në Infrastrukturen rrugore përbejnë rreth 42% të totalit të buxhetit.

2. Mjedisi dhe mbajtja pastër e tij.

Në përmbushje të qëllimit të politikës, objektivat e këtij programi fokusohen në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike, rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve shtimin e sipërfaqeve të gjelbëruara si dhe përmirësimi cilësor i shërbimit të kapaciteteve të pastrimit të qytetit dhe zonave përreth do të jenë një nga shtyllat kryesore të këtij buxheti, pesha e programit buxhetor të shërbimeve publike, vendore është **20%** e totalit të buxhetit

3. Arsimi, Kultura, Rinia dhe Sportit.

Politika e programit ka si qëllim prioritar mirëfunksionimin përmirësimin e infrastruktures arsimore dhe kushteve të mësimdhënies në shkollat dhe kopeshte. Përsa i takon kulturës synon identifikimin e të gjitha pasurive kulturore dhe artistike të zonës dhe pasurimin e jetës sociale, kulturorë gjithashtu në këtë program do të kenë një mbështetje të veçantë edhe nxënësit excellent. Po kështu do të punohet fort që të arrihen:

- Rigjallërimi i jetës sportive dhe kulturore të qytetit
- Mbështetje Klubit Sportiv "FK Vora"
- Investimi për fushën e sportit

Për vitin 2016 për këtë program do të financohet me një fond total në shumën rreth 6,500,000 lekë që përbën 2% të totalit të buxhetit të Bashkisë Vore.

KAPITULLI II

BUXHETI I BASHKISË VORË PËR VITIN 2016

Ky buxhet u hartua me objektivin për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në përdorimin e burimeve financiare, paralelisht duke mirëmenaxhuar të ardhurat dhe shpenzimet dhe duke u bazuar në :

- Hartimi i buxhetit të vitit 2016, është një planifikim i qëndrueshëm buxhetor, me një përfshirje në këtë proces të të gjitha strukturave përgjegjëse.
- Programet buxhetore. Për vitin 2016, bazuar në funksionet që përcakton Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në strukturat buxhetore të programeve të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe në funksionet që bashkia ushtron aktualisht, janë klasifikuar një pjesë e programeve, nëpërmjet klasifikimit të aktiviteteve (detyrave) të përfshira në çdo program.
- Përgatitja e buxhetit në bazë të performancës. Kjo formë synon formulimin e qartë të prioriteteve në nivel programi në efikasitetin e realizimit të shpenzimeve.
- Prezantimi i buxhetit me programe sektoriale dhe prioritare të mbështetura në kostot reale, ku përcaktohen qartë objektivat për çdo sektor si dhe raporti produkt/rezultat
- Transparençën e mbledhjes së të ardhurave dhe shpenzimit të fondeve ndaj komunitetit, si qeverisja më e afërt me qytetarët.
- Konsultimet paraprake me drejtuesit e menaxhimit të programeve.
- Informacionin e marre nga konsultimet me publikun dhe qytetarët.

Parashikimet financiare në Buxhetin e vitit 2016 reflektojnë:

- Parashikimin e të Ardhurave: Reflektimi i politikave fiskale të aplikuara gjatë vitit 2015, me ndryshimet përkatëse;
- Parashikimin e Shpenzimeve: Alokimin/shpërndarjen e të ardhurave për:
 - Shpenzimeve kapitale sipas programeve buxhetore të zhvillimit
 - Shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes për përmbushjen e funksioneve;
 - Shpenzime personeli;

Programi financiar për vitin 2016 bazohet në analizën e kostove të programeve dhe shërbimeve, ecurinë e tyre në vite dhe nevojat reale në sektorë të veçantë.

Në terma të përgjithshëm programi financiar për vitin 2016 paraqet:

- Buxheti total me një Rritje prej **68%**, në krahasim me planifikimin e vitit paraardhës, e cila diktohet nga një rritje e dukshme për efekt të reformës administrativo-territoriale;
- Raporti midis shpenzimeve korente dhe atyre kapitale, arrin respektivisht në **56%** me **44%** ;
- Buxheti ka në fokus rritjen e cilësisë së shërbimeve në sektorët prioritarë, shërbime publike dhe infrastrukturë rrugore;

- Procedurat e buxhetimit janë të fokusuara tek produkti/rezultati, për çdo program,
- Është ruajtur i pandryshueshëm niveli i shpenzimeve administrative në bazë të realizimit faktik të tyre në periudhën paraardhëse,
- Zbatimi i politikave kombëtare për përcaktimin e nivelit të shpenzimeve për paga, bazuar në strukturën dhe nivelin e miratuar nga Këshilli i Bashkisë Vorë.
- Ky buxhet garanton transparencën në përdorimin e fondeve publike si dhe rritjen e efijencës dhe efektivitetit të menaxhimit të shpenzimeve publike.

II.1 TË ARDHURAT E BASHKISË VORË PËR VITIN 2016

Veprimtaria e Bashkisë së Vorës në fushën e sistemit fiskal vendor funksionon mbështetur në bazën ligjore, si më poshtë:

- Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.9920, datë 26.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.____, datë __. __. 2015 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Vore për vitin 2015”
- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.____, datë _____.____.2015 “Për Miratimin e paketës fiskale për vitin 2015”

Programi Buxhetor shoqërohet njekohesisht dhe me paketën fiskale e cila ka për qëllim promovimin e disa sektoreve të vecante ekonomike si dhe evidentimin e bizneseve që kanë ndikim negativ në mjedis dhe marrjen e masave fiskale për të zhbërë efektet negative të tyre.

Bashkia garanton funksionimin e saj duke përfutuar burime financimi kryesisht nga taksat vendore të miratuara sipas akteve ligjore dhe nga taksat & tarifatat vendore të miratuara me vendime të Këshillit Bashkiak, si për bashkinë e Vores ashtu edhe për dy njesitë administrative, më konkretisht:

- a. Taksa vendore e Biznesit të Vogël;
 - b. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme;
 - c. Taksa e fjetjes në hotel;
 - d. Taksa e ndikimit në infrastrukture nga ndërtimet e reja;
 - e. Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
 - f. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura;
 - g. Taksa për zënien e hapësirës publike;
 - h. Taksa e tabelës
 - i. Takse trualli;
 - j. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave;
 - k. Tarifa e parkimit të automjeteve;
 - l. Përdorimi asetëve;
 - m. Tarifa të tjera Administrative;
 - n. Detyrime të prapambetura;
- Në zbatim të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, Struktura kryesore e ndjekjes dhe arketimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore është caktuar S.T.T.V, ndërkohë që ndjekja e disa prej taksave e tarifave vendore bëhet nga agjentë tatimorë të jashtëm si më poshtë:

- a. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura (DRSHTR);
- b. Taksa e kalimit të të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme (ZVRPP);

Krahasuar me Faktin e vitit 2015, parashikimi i të ardhurave për vitin 2016, jepet si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

	Fakti 2015 (nentor)	Parashikimi 2016
Taksat vendore	178,372,493	221,418,500
Tarifat vendore	43,618,349	135,955,520
Të tjera	25,776,711	20,214,000
Totali	247,767,711	377,588,020

Grafikisht, raporti i parashikimit të të ardhurave për vitin 2016, paraqitet si vijon:




Figura 1

Për parashikimin e vitit 2016, janë marrë në konsideratë:

- Ecuria e deritanishme e realizimit të të ardhurave (Fakti 2015);
- Rritjen e bazës së taksueshme
- Ndryshimet sipas reformes administrative territoriale;
- Uljen e evazionit fiskal duke ulur numrin e debitorëve dhe shtimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet të peregjistruar;
- Përsosja e sistemit database informatikë dhe monitorimit të taksave

Të renditura sipas grupeve dhe klasifikimeve buxhetore, të ardhurat ndahen në:

Të ardhurat tatimore.

- Për vitin 2016 të ardhurat tatimore arrijnë në shumën **221,418,500lekë** ose **58.6%** të totalit nga taksat & tarifet. Ky parashikim është menduar të arrihet nëpërmjet rritjes së të ardhurave nga burimet kryesore si: taksa mbi pasurinë, taksa mbi biznesin vogël,

taksa e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e ndërtimit, lejet e shfrytëzimi dhe lejet e përdorimit.

- Të ardhurat nga taksat vijojnë të mbetën burimi kryesor i të ardhurave pasi përbëjnë rreth 86 % të totalit nga taksat & tarifat.

Të ardhurat nga tarifat e shërbimit.

- Të ardhurat nga tarifat e shërbimit për vitin 2016 parashikohen në shumën **135,955,520 lekë** ose **36%** të totalit nga taksat & tarifat.
- Vijojmë të përballemi me evazion fiskal të të ardhurave nga qytetarët .
- Për pasojë një pjesë e mirë e shërbimeve publike do të vazhdojnë të subvencionohen nga të ardhurat prej taksave vendore.

Të ardhura të tjera.

- Për vitin 2016, të ardhura të tjera parashikohet në shumën **20,214,000 lekë** ose **5.4 %** të totalit nga taksat & tarifat.

II.1.2 TE ARDHURA NGA PROCESI I LEGALIZIMIT

Në këtë taksë përfshihen edhe të ardhurat e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga procesi i legalizimit. Në parashikimin e të ardhurave nga kjo taksë është llogaritur që vlera prej 25.000.000 lekë vlerë e cila mendojme që të realizohet nga procesi i legalizimit të objekteve pa leje në territorin e qytetit të Vores dhe në të gjithë fshatrat për rreth, njëkohësisht edhe në njesinë Preze dhe Berxulle.

II.1.3 TAKSA E KALIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme aplikohet për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Për rrjedhojë e mungesës së lejeve të shfrytëzimit dhe mos hipotekimi i objekteve të ndërtuara, janë krijuar mungesa të ndjeshme në realizimin e të ardhurave nga kjo taksë.

II.1.4 TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA

Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit.

E ardhura nga taksa, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (drejtoritë rajonale) para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Për mjetet që regjistrohen për herë të parë, taksa llogaritet proporcionalisht për periudhën e mbetur të vitit. Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësive të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore por e konvertuar në përqindje, në masën 18 % e të ardhurave vjetore.

II.2 TRANSFERTAT NGA BUXHETI I SHETIT

Niveli i transfertës së kushtëzuar dhe të pakushtëzuar përcaktohet çdo vit në ligjin e Buxhetit të Shtetit.

Transferta e Pakushtëzuar

Niveli (tavani) i transfertës së pakushtëzuar për vitin 2016, (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore), financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në pushtetin vendor deri në vitin aktual.

Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës së pakushtëzuar do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës përkatëse të saj.

Rritja vjetore dhe afatmesme e transfertës së pakushtëzuar parashikohet në udhëzimin vjetor të Ministrisë së Financave “Për hartimin e buxhetit vendor”. Transferta e pakushtëzuar për vitin buxhetor që planifikohet, njoftohet nga Ministria e Financave përpara hartimit të buxhetit të vitit.

TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR	2015	2016
	45 986 000	86 140 000

Transferta e Kushtëzuar

Transferta e kushtëzuar jepet për financimin e një pjese të shpenzimeve për funksionet e përbashkëta dhe për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Këto fonde përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë miratuar. Njësitë e qeverisjes vendore nuk mund ti përdorin për qëllime të tjera, përveç atyre të përcaktuara në ligjin për buxhetin. Shumat e këtyre transfertave, të mbetura të papërdorura në fund të vitit buxhetor, nuk mbarten në vitin pasardhës, por rikthehen në buxhetin e shtetit. Mbeshtetur kjo në ligjin nr147/2015 date 17.12.2015 “Per buxhetin e viti 2016”, si dhe në shkresën nr. 18025 Prot, date 28.12.2015, Ministria e Financave, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit.

- Transfertat specifike për financimin e funksioneve të reja janë si më poshtë:

FUNKSIONET E REJA	Arsimi parashkollor	Arsimi parauniversitar	Administrimi i pyjeve	Ujitje - Kullim
Fondi 600 – 602	31 519 000	1 857 000	613 000	2 198 072
NR. PUNONJESVE	46	4	1	1

Fondet e kushtëzuara për financimin e funksioneve të deleguara, nuk miratohen si pjesë përbërëse e buxhetit të njësisë vendore, por reflektohen në dokumentin e realizimit të buxhetit, si fonde të administruara nga njësitë vendore.

Sipas akteve ligjore në fuqi, funksione të deleguara në pushtetin vendor janë:

- *Shërbimi i gjendjes civile* si funksion i deleguar i detyrueshëm, parashikimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime bëhen nga Komunitatet dhe bashkitë, në bazë të kuotave dhe udhëzimeve më të detajuara që bëhen nga Ministria e Brendshme. Numri i punonjësve dhe kuotat përkatëse për këtë funksion përcaktohen nga Ministria e Brendshme.

- *Përkrahja sociale*, si funksion i deleguar i detyrueshëm, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta detajon në fillim të vitit fondet për përkrahjen sociale për çdo njësi të qeverisjes vendore, në mënyrë specifike për ndihmën ekonomike dhe për pagesën e paaftësisë.
- *Projektet e financimi nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve* – për vitin 2016 Bashkia Vore është financuar për investimin në rrugën “Rikonstruksion, sistemim dhe asfaltim i rrugëve të brendshme lagje Koder Vore”

Shuma e transfertave të kushtëzuara do të jetë rezultat i shpenzimeve sipas artikujve për çdo aktivitet që kryhet në zbatim të funksioneve të deleguara ose të përbashkëta. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore dhe shpenzimeve operative si dhe të mirëmbajtjes do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës.

II.3 PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2016

Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë së Vorë dhe dy njesive administrative Preze dhe Bexulle për vitin 2016 për të gjitha funksionet parashikohet në masën 549,487,113 lekë. Bashkia Vorë në planifikimin dhe menaxhimin e shpenzimeve në Buxhetin e vitit 2016 synon:

- Transparenca e plotë e përdorimit të fondeve publike;
- Administrimi i fondeve me efikasitet dhe efektivitet
- Mëmbajtjen në të njëjtin nivel të shpenzimeve të personelit,
- Rritjen e nivelit të investimeve.
- Buxheti paraqitet i balancuar (pa deficiet) të ardhurat = shpenzimet
- I besueshëm
- Gjithëpërfshirës dhe në koherencë me nevojat e qytetarëve

Në Buxhetin e vitit 2016:

- Raporti mes shpenzimeve korente dhe atyre kapitale është respektivisht 56 % dhe 44%. Konkretisht ndahen në:
 - Shpenzime personeli 24 %
Pesha e shpenzimeve të personelit ndaj totalit të buxhetit është ruajtur në po të njëjtat nivele në krahasim me vitin e mëparshëm.
 - Shpenzime operative 31.5 %
Shpenzimet operative zënë 29.3 % të totalit të buxhetit 2015.
 - Investime 44 %
Pesha e investimeve ndaj totalit të buxhetit është në 53.7 %, vendin kryesor në këto pesha të zënë investimet me kontrata të lidhura dhe një pjesë e investimeve të reja që do të startojnë gjatë këtij viti.

- Fondi rezerve dhe Kontigjence 0.5 %
Fondi rezerve dhe kontigjence zene 0.5% të totalit të buxhetit përdorimi i ketyre fondeve behet vetem me miratimin e Keshillit Bashkiak .
Shpenzimet e përgjithshme ndahen në :
 - Shpenzime kapitale
 - Shpenzime korente

Në vijim paraqitet analiza sipas artikujve e shpenzimeve buxhetore për vitin 2016.

II.3.1 Shpenzimet kapitale

Parashikimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2016, ka mbajtur në vëmendje:

- Prioritetet e përcaktuara në Programin e Kryetarit të Bashkisë ;
- Detyrimet që rrjedhin nga kontrata te lidhura per investimet ne proces;
- Shkallën e ndikimit të pritshëm në zhvillim ekonomik e social dhe punësimin;
- Planifikimin në bazë kostosh për njësi të përcaktuara sipas punimeve të kryera.

Për vitin 2016 fondi total për shpenzime kapitale është në shumën 241,283,651 leke ose 44% ndaj totalit të shpenzimeve.

Në investimet kapitale përfshihen:

- Investime te reja të planifikuara, sipas programeve të zhvillimit , në masën 12 % të totalit të investimeve;
- Objektet në vazhdim nga vitet e mëparshme, në masën 73.4% të totalit të investimeve;
- Investime ne blerje te ndryshme ne masen 14.6% te totalit te buxhetit

II.3.2 Shpenzimet Korente

Shpenzimet korente për vitin 2016 parashikohen në shumën 308,203,462 lekë dhe përbëjnë 56 % të totalit të shpenzimeve për këtë vit buxhetor.

Planifikimi synon ruajtjen në po te njëjtin nivel të shpenzimeve administrative në funksion të rritjes së shpenzimeve për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike nëpërmjet shpërndarjes sa më të drejtë të burimeve midis programeve prioritare të zhvillimit dhe nevojave të qytetarëve.

Shpenzimet korente përbëhen nga:

- Shpenzimet për personelin,
- Shpenzimet operative për realizimin e funksioneve kryesore,

Shpenzimet korente sipas programeve të bashkisë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

PROGRAMET BUXHETORE	Shpenzimet Personeli (paga dhe sigurime)	Shpenzime Operative	Transferta Te Brendshme	F. Rezerve & Kontigjenca	Fuksion I deleguar (paga.sigurime ,shpz.operativ)	Totali
Programi Buxhetorë i Shërbimeve Publike Vendore,	13,749,780	94,376,921				108,126,701
Programi Buxhetorë i Administratës	76,000,320	32,489,510	8.861.000	2,788,774	36,187,257	156,326,861
Programi Buxhetor i Ujesjellesit	6,249,900	21,000,000				27,249,900
Programi i Buxhetore i Kulturës, Rinisë, Turizmit dhe Sportit”		6,500,000				6,500,000
Programi i Buxhetore i Perkahjes Sociale		10,000,000				10,000,000
TOTALI	96,000,000	155,505,431	8.861.000	2,788,774	36,187,257	299,342,462

1. Shpenzime për Personelin

Totali i shpenzimeve të personelit te administrates (paga dhe sigurime shoqërore) për të gjitha funksionet e Bashkisë Vorë dhe funksionet e deleguara është parashikuar në shumën **165,187,861 lekë** dhe kane peshe specifike rreth **30 %** të totalit të buxhetit.

Shpenzimet operative te personelit për vitin 2016 janë parashikuar në nivel programi, në përputhje me funksionet për të cilat kontribuon çdo punonjës i administratës së Bashkisë .

Tranferta te brendeshme jane 8.861.000 leke te cilat perbehen nga transferimi per ekipin e futbollit “Vora “ 8,000,000 leke dhe transferime nga këshillin e qarkut Tirane ne vleren 861,000 leke qe eshte 0.5% i vendosur nga këshilli Bashkiak Vore.

2. *Fondi rezervë dhe kontigjenca*

Fondet speciale (Fondi rezerve dhe Fondi Kontigjence) janë parashikuar në vlerën **2,788,774 leke** dhe kanë peshe specifike rreth **0.5 %** të totalit të buxhetit.

3. *Shpenzimi i shërbimeve publike:*

Totali i shpenzimeve të personelit (paga dhe sigurime shoqërore) është parashikuar në shumën **108,126,701 leke** dhe kanë peshe specifike rreth **20%** të totalit të buxhetit, duke ruajtur faktin e realizuar për vitin 2015 si dhe duke marrë parasysh reformat e re administrative territoriale.

4. *Shpenzimet për Arsimin, Kulturën, Rininë, Turizmin dhe Sportin*

Shpenzimet operative të Arsimit, Kulturës, Rinisë, Turizmit dhe Sportit për vitin 2016 janë parashikuar në vlerën **6,500,000 leke** dhe kanë peshe specifike rreth **1.5%** të totalit të buxhetit.

5. *Shpenzime për perkrahjen sociale.*

Në buxhetin e vitit 2016, është parashikuar **5%** e buxhetit për perkrahje sociale për familjet në nevojë, kjo shumë është parashikuar në vlerën **10.000.000 leke**.

KAPITULLI III

PROGRAMET BUXHETORE

Ky kapitull, prezanton me hollësi politikën, qëllimet, objektivat dhe produktet e secilit prej programeve të zhvillimit që parashikohen të realizohen për periudhën në vazhdim nga të gjitha njësitë shpenzuese në bashkinë Vorë.

Bazuar në funksionet e veta, të përbashkëta e të deleguara të pushtetit vendor, përcaktuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në strukturat buxhetore të programeve që parashikojnë aktet ligjore mbi buxhetin si edhe në funksionet që ushtron aktualisht bashkia, programet buxhetore janë si vijon:

- Programi Buxhetor i Shërbimeve Publike Vendore,
- Programi i Buxhetor i Infrastrukturës Rrugëve ,
- Programi Buxhetor i Administratës ”
- Programi i Buxhetor i Arsimit, Kulturës, Rinisë, dhe Sportit”
- Programi Buxhetor i shërbimeve dhe Kujdesit Social ”
- Programi Buxhetor i Shërbimit të Gjëndjes Civile,

Totali i shpenzimeve (korente dhe kapitale) në lekë, për çdo program mbështetur në të ardhurat që do të realizojë bashkia Vore paraqitet në tabelë e mëposhtme:

Në lekë

Programi	Buxheti 2016
Programi Buxhetor i Shërbimeve Publike Vendore,	108,126,701
Programi Buxhetor i Isfrastrukturës Rrugëve ,	241,283,651
Programi Buxhetor i Administratës	156,326,861
Programi Buxhetor i Ujesjellesit	27,249,900
Programi Buxhetor i Arsimit, Kulturës, Rinisë, dhe Sportit”	6,500,000
Programi Buxhetor i Shërbimeve dhe Kujdesit Social	10,000,000
TOTAL	549,487,113

PROGRAMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE VENDORE

Politika e Programit

Politika e Shërbimeve Publike Vendore synon në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe mbrojtjes së ambjentit kundrejt zhvillimit urban të qytetit.

Qëllimi i Politikës

Kjo politikë ka për qëllim ofrimin me cilësi, sipas standardeve bashkëkohore të shërbimeve publike në të gjithë territorin: Shtimin e sipërfaqeve të gjelbërta; Shtimin e ambjenteve shlodhëse; argëtuese dhe sportive, Përmirësimin e infrastrukturës së kanalizimeve të ujrave të zeza; Përmirësimin e shërbimit të mbledhjes së mbetjeve urbane; Investimet për shërbimet publike.

Standardet e politikës

Standarde bashkëkohore do të përdoren për të vënë në funksionim këtë program në të gjithë territorin Administrativ të Bashkisë Vore duke u bazuar në standardet më të mira në vend dhe ato të vëndeve të zhvilluara.

Objektivat e Politikës së Programit

Në përmbushje të qëllimit të politikës, objektivat e këtij programi fokusohen në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike, pajisjen e tyre me elementët e nevojshëm për sigurimin e një mjedisi bashkëkohor dhe rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve:

1. Rehabilitimi i sipërfaqeve të gjelbërta egzistuese;
2. Shtimi i sipërfaqe të gjelbërta;
3. Shtimi i ambjenteve shlodhëse, argëtuese dhe sportive
4. Mirëmbajtja e Rrugeve, kanalizimeve të ujrave të zeza e te bardha.
5. Mbulimi me shërbimin e mbledhjes së mbetjeve urbane të të gjithë territorit.
6. Shtimi i kapaciteteve grumbulluese të mbetjeve urbane.
7. Pastrimi i qytetit dhe shërbimi i ndriçimit të qytetit.
8. Mirëmbajtja e varrezave.

PROGRAMI I INFRASTUKTURES RRUGEVE

Politika e Programit Politika e menaxhimit të rrugëve synon në përmirësimin të jetës së qytetarëve dhe mbrojtjes së ambientit kundrejt zhvillimit të rrjetit rrugor.

Qëllimi i Politikës Metoda efikase për menaxhimin e kërkesës dhe sigurimin e një informacioni më të mirë për të rritur lëvizshmërinë në zonën e bashkisë Vore dhe të hyrjeve daljeve. Rritja e cilësisë së Rrugëve eksistuese dhe ndërtimi i rrugëve të reja. Përmirësimi i gjithë instrumentave dhe elementëve të sinjalistikës rrugore në qytet dhe zonat përreth.

Standardet e politikës Për projektimin e rrugëve të reja shpejtësia e projektimit në qendrat banuara është deri në 40 km/h; .

Objektivat e Politikës së Programit

1. Rehabilitimi i rrugëve egzistuese me rëndësi për përmirësimin e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave;
2. Ndërtimi i rrugëve të reja duke rritur kapacitetet e rrjetit rrugor,

Shpenzimet kapitale për vitin 2016

Objekte në vazhdim:

1. Rikonstrukcion, Sistemim dhe Asfaltim I Rrugëve të Brëndëshme Lagje Kodër Vorë Loti 2”.
2. Sistemim dhe Asfaltim i Rrugëve të Brëndëshme Lagje e Re Vore. Loti 3.
3. Sistemim Dhe Asfaltim I Rrugëve të Lagjeve të Fshatit Dedej. Aksi 1. Nënloti 1/1
4. Sistemim Dhe Asfaltim I Rrugëve të Lagjeve të Fshatit Dedej. Aksi 2. Nënloti 1/2
5. Ndërtim I KUB,KUZ,Ujësjiellësit të Rrugëve të fshatit Dedej .Aksi 1 dhe Aksi 2. Nënloti 3/1
6. Ndërtim I KUB,KUZ,Ujësjiellësit të Rrugëve të fshatit Dedej .Akset: 2,3,4,5,6. Nënloti 3/2
7. Ndërtim I mureve mbajtës e pritës, Betoni e Betonarme të Rrugëve të fshatit Dedej. Aksi 1.
8. Sistemim,Asfaltim I Rrugëve të brëndëshme të fshatit Gërdec Dega C dhe Dega D.
9. Sistemim,Asfaltim I Rrugëve të brëndëshme të fshatit Gërdec Dega E.
10. Rikonstrukcion ,Asfaltim I Rrugës së Varrezave Vorë dhe segmenti i rrugës Ambulancë e vjetër - ish reparti Ushtarak
11. Sistemim , Asfaltim i rrugës Ambulancë e vjetër -Rep Ushtarak Vorë dhe Segmenti i Rrugës Varreza të Qytetit Vorë (Faza 2)
12. Sistemim, Asfaltim i Rrugës ,Ruga Kryesore Lagje Dunga -Varreza (Sektori Marikaj) L=470MI
13. Rikonstrukcion, Asfaltim i Rrugëve të Brëndëshme të fshatit Mucaj Aksi 01.

14. Rikonstruksion Dhe Asfaltim I Rrugeve Te Fshatit Gjokaj, Rruga Zalli I Gjokajve, Rruga Pylli Balliut, Rruga Shehelerve, Rruga E Arave.
15. Sisitemim Dhe Asfaltim Rruga Dytesore Tirane Vore, Lagjia Koder Vore L=243ml
16. Sisitemim - Asfaltim i Rruges Pavarsia Fshati Sharge Bashkia Vore
17. Sisitemim - Asfaltim Rruges se Mimiozave Koder Vore, Bashkia Vore (Perballe godines se bashkise Vore)
18. Sistemim - Asfaltim Rruges Allcaushaj Fshati Marikaj, Bashkia Vore
19. Sistemim - Asfaltim Rruges Toptaneve Fshati Marikaj, Bashkia Vore
20. Sistemim - Asfaltim Rruga Kodra e Xhirajve Fshati Marqinet, Bashkia Vore
21. Sistemim, Asfaltim Rruges Bashkimi Vore, Bashkia Vore. Lidhja e Rruges Kodra e Bukur me Rrugen Fusha e Sportit)
22. Sistemim, Asfaltim i Dy Segmenteve te Rruges Rilindja Fshati Marqinet (2), Segmenti 1 dhe 2 , Bashkia Vore.
23. Garanci punimesh

Objekte te reja te parashikuara per vitin 2016 :

1. Sistemim- Rikonstruksion I rrugeve te brendeshme Lagje re Loti 1+2.
2. Rehabilitim, Sistemim I Lumit Tona.
3. Ndertim KUZ Domje.
4. Ndertim I KUZ Rruga Muharrem Bajrektari , Pashtriku.
5. Sisitemim Asfaltim I rruges se fshatit Koder Berxulle.
6. Sistemim Asfaltim I rruges Ura e Limuthit, njesia Administrative Berxulle.
7. Sistemim dhe Asfaltim I rruges Gjeç - Fushe, njesia Preze.
8. Furnizim, vendosje peme dekorative.
9. Rehabilitim, Sistemim vendosje tapeti te stadiumit te qytetit Vore.
10. Rikonstruksion dhe Asfaltim I rruges Sul-Haxhi.

PROGRAMI BUXHETORE I ADMINISTRATES

Politika e Programit

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Bashkisë Vorë, zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese dhe garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe përdorimit me efektivitet të burimeve financiare.

Qëllimi i Politikës

Ky program parashikon menaxhimin financiar të Bashkisë dhe përfshin shpenzimet e nevojshme administrative për funksionimin normal të administratës vendore dhe përmbushjen e misionit të bashkisë Vorë për mobilizimin dhe përdorimin me efikasitet dhe efektivitet të burimeve financiare publike, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, të politikave të mandatuara.

Objektivat e Politikës

1. Përmirësimi në vazhdimësi i aftësive drejtuese të stafit të Bashkisë dhe niveleve të tjera të vendimmarrjes në varësi të saj,
2. Hartimi dhe propozimi i ndryshimeve në politikën fiskale, me qëllim mbështetjen e vazhdueshme të rritjes ekonomike,
3. Ndërtimin e një sistemi efektiv të programimit buxhetor, mbi bazë programesh Buxhetore,
4. Menaxhimi aktiv me bazë koston dhe riskun,
5. Përmirësimi i menaxhimit dhe përdorimit të fondeve publike me transparencë, efikasitet, ekonomike dhe implementimin e zhvillimin e një sistemi bashkëkohor e të qëndrueshëm për kontrollin e brendshëm financiar, me një shërbim të pavarur e funksional të auditimit të brendshëm,
6. Krijimi i një institucioni eficient, ku të përmirësohen në vazhdimësi aftësitë e stafit drejtues, kapacitetet institucionale dhe teknike, me qëllim administrimin korrekt të fondeve,
7. Të asistohen dhe nxiten tatimpaguesit në mënyrë që të likuidojnë detyrimet në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor, duke siguruar që të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, të shkojnë për llogari të buxhetit të Bashkisë Vorë,
8. Të sigurohet zgjerimi i bazës së taksueshme, rritja e numrit të taksapaguesve, dhe reduktimi i elementëve të evazionit,
9. Forcimi i auditimit mbi bazën e riskut,
10. Për një shërbim të ndershëm, të plotë dhe cilësor për biznesin dhe qytetarët,
11. Krijimi i sistemit të informacionit dhe bankave të nivelit të dytë, për ofrimin e shërbimit ndaj taksapaguesve,
12. Fushata informative dhe sensibilizuese për ndërgjegjësimin e publikut për detyrimet ligjore ndaj Bashkisë,
13. Organizimi i trajnimeve me stafin e ri dhe atë ekzistues,
14. Përmirësimi i ambjenteve të punës për punonjësit e Bashkisë,
15. Mirëmbajtja e sistemit kompjuterik dhe faqes së internetit të Bashkisë për pasqyrimin me transparencë të punës së Bashkisë,
16. Përmirësimi i legjislacionit vendor dhe përafrimi i tij me standardet e BE, lidhur me menaxhimin e mjedisit, administrimin e ndërtesave dhe aseteve të tjera të Bashkisë si dhe në fushën e planifikimit territorial.

PROGRAMI I ARSIMIT,KULTURES,RINISE DHE SPORTIT

Politika e Programit

Programi i Arsimit, Kultures, Rinise dhe Sportit parashikon hartimin e politikave në përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe kushteve të mësimdhënies në shkollat dhe kopeshte. Përsa i takon kulturës synon identifikimin e të gjitha pasurive kulturore dhe artistike të zones dhe pasurimin e jetës sociale, kulturore e artistike për qytetarët, duke ndikuar në këtë mënyrë drejtpërdrejtë në imazhin e bashkisë.

Parashikon organizimin e aktiviteteve të ndryshme rinore dhe sportive. Ky program do të shërbejë për zhvillimin e qytetit të Vores si një qytet plot gjallëri.

Qëllimi i Politikës

Politika e programit ka si qëllim prioritar, propozimin e projekteve të Qeverisjes Vendore për ndërtimin e godinave të reja shkollore dhe parashkollore në të gjithë territorin e Bashkisë Vore, për shkak të rritjes së demografisë dhe zhvillimit ekonomik e social duke synuar kështu rritjen e kapaciteteve të arsimit të përgjithshëm parashkollor e shkollor, ka për qëllim intensifikimin e jetës artistike kulturore për të gjitha grupmosha, për përmirësimin e cilësisë së jetesës për të gjithë qytetarët. Duke i nxjerrë në pah vlerat e historinë e hershme të qytetit. Politikat e këtij programi janë të lidhura ngushtë me organizmin dhe mbarevajtjen e aktiviteteve të ndryshme rinore për të bërë të mundur aktivizimin e rinisë jo-aktive si dhe nxitjen, zhvillimin dhe përhapjen e kultures sportive nepermjet organizimit të aktiviteteve të ndryshme me karakter kulturor e sportive. erket forcimit të rolit të bashkisë në evidentimin e problematikave të rinjve dhe zgjidhjen e tyre.

Standardet e politikës

Kushte të përmirësuara të sistemit parauniversitarë dhe edukimit, orientim drejt një sistemi modern në dije dhe informacion të të gjithë nxënësve, studenteve dhe qytetarëve si dhe bashkëpunimit intensivisht me botën universitare. Ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës, artit dhe turizmit. Rritja e mireqenies sociale përmes zbatimit të programeve të ndryshme social-kulturore e sportive, ngritjes së qendrave ditore për të gjitha kategoritë e grupmoshat.

Objektivat e Politikës së Programit

1. Mirembajtjen e objekteve arsimore (Shkollat dhe Kopeshtet)
2. Mobilimi i objekteve arsimore me të gjithë elementët për një proces mësimdhënie cilësor.
3. Garantimin e objekteve arsimore me sisteme ngrohje.
4. Pajisja e objekteve që rikonstruktohen me palestra, terrene sportive, laboratorë etj
5. Aplikimi dhenjes së shperblimeve për nxënësit e dalluar.
6. Ofrimi i aktiviteteve të shumta kulturore sportive e artistike për nxënësit dhe nga vete nxënësit.
7. Të identifikojë të gjitha vlerat e trashëgimisë kulturore, monumentet e kulturës, traditën folklorike, artizanatin etj,.
8. Të nxisë leximin dhe shkrimin për pasurimin e veprimtarisë në letra si një nga format për mbrojtjen, forcimin dhe promovimin e historisë dhe gjuhës si vlera kulturore etj,.
9. Të organizojë sipas kalendarit festat e traditës, të ditëve kombëtare e ndërkombëtare,
10. Dhenien e shperblimeve për studentet e shkëlqyer apo ata me pamundësi ekonomike.
11. Nxitjen e aktiviteteve sportive,.
12. Organizimin e sportit në shkollat dhe organizimin e aktiviteteve të shumta sportive midis shkollave.

Bashkengjitur ketij materiali gjenden tabelat e parashkimit te buxhetit per vitin 2016

Punoi materialin e Buxhetit

Konceptoi/Punoi:

Aida Dedja

Rovena Gjoni

MIRATOI
KRYETAR
FIQIRI ISMAILI

Konfirmuan

Nepunes Autorizues A. Muca

Sek.Pergjithshme A. Zela

Administratori njesise Preze S.Kulli

Administratori njesise Bexulle K.Haka

Pergj.Sek Juridik B. Ciku

Pergj.Sek.Taksave A.Subashi

Pergj.Sek.Sherb.Publike A.Kasa

Pergj.Sek.Administrates M. Shytko

Dr. DPKZHT L. Beta

Pergj.Sek.Arsimit Y. Kodra

Pergj.Sherb.Sociale L.Picari

Pergj. Sek.Bujqesise A. Sheshaj